



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE



Procesverbali i Mbledhjes

**Këshilli Konsultativ mes Qeverisë Qendrore dhe Qeverisë Vendore
Mbledhja e datës 2 shtator 2026**

Tabela e përmbajtjes

Hapja e mbledhjes	1
1.Projektligji “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve” nga Ministria e Mjedisit	2.
2.Projektligji ”Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” i ndryshuar.....	3
3. Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr. 162 datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave ”Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programit të pakësimit të shkarkimeve në ajër”	3
4. Projektligji ”Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” të ndryshuar.....	3
5. Projektligji ”Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar	4
6. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar.....	4
7. Projektvendimi “Për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillimin e sektorit minerar 2026-2040“.....	5
8. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar.....	6
Shtojcë:	
Të pranishëm	7

Hapja e mbledhjes

Në zbatim të VKM nr. 244, datë 17.4.2024 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, më datë 2 shtator 2026 u zhvillua mbledhja e Këshillit Konsultativ. Mbledhja u zhvillua online, në platformën Teams , ku morën pjesë anëtarët e Këshillit Konsultativ, përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe donatorë të huaj.

Mbledhja u kryesua nga z. *Stiljan Llavdaniti, Drejtor i Përgjithshëm, i komanduar, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore* në fjalën e tij përshëndetëse, falënderoi zëvendësministrat pjesëmarrës, shoqatat e bashkive dhe të qarqeve, kryetarët e bashkive dhe përfaqësuesit e NJVV-ve

PROJEKTAKTE TË KONSULTUARA

1. Projektligji “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve” propozuar nga Ministria e Mjedisit u prezantua nga Znj. Klodiana Marika, Drejtor për Biodiversitetin dhe Zonat e Mbrojtura.

Znj. Marika theksoi se projektligji ka pësuar ndryshime të konsiderueshme me qëllim qartësimin e natyrës së kësaj shoqërie e cila do të jetë një faktor operacional, duke shmangur çdo mbivendosje funksionesh me Ministrinë e Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Pyjeve apo njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat mbeten administruese të fondit pyjor. Propozimi përfshin krijimin e një shoqërie aksionare me 100% kapital shtetëror për veprimtari ekonomike, teknike dhe operacionale. Ajo që është thelbësore nuk ndryshon asnjë nga kompetencat e bashkive apo agjencive ekzistuese. Synimi është rritja e kapaciteteve për pyllëzim, ripyllëzim, rehabilitim, ngritjen e fidanishteve dhe tërheqjen e investimeve. Kjo reformë adreson hendekun e kapaciteteve teknike dhe zbatuese të bashkive dhe institucioneve qendrore, mungesën e një rrjeti të organizuar fidanishtesh shtetërore, vështirësitë në menaxhimin e projekteve shumëvjeçare, si dhe varësinë e lartë nga financimi buxhetor. Shoqëria e re nuk ushtron asnjë funksion politikbërës, rregullator, planifikues, administruer, monitorues ose inspektues.

Arkitektura institucionale parashikon rolin e Ministrisë si politikbërëse dhe mbikëqyrëse strategjike. Agjencia Kombëtare e Pyjeve bën rregullimin, monitorimin dhe kontrollin e performancës së bashkive. Shoqëria Shtetërore e Pyjeve bën zbatimin operacional, veprimtarinë ekonomike, menaxhimin e projekteve/granteve dhe shërbimet teknike. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore administrojnë fondin pyjor sipas kompetencave ligjore në fuqi (Ligji 57/2020). Shoqëria do të veprojë vetëm mbi bazë kërkesë, marrëveshjeje bashkëpunimi të miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës ose instrumentesh të tjera juridike, dhe në asnjë mënyrë si zëvendësuese e pushtetit vendor. Për sa i përket modelit financiar, shoqëria në fazën fillestare do të kapitalizohet nga Buxheti i Shtetit. Në periudhën afatmesme synohet të jetë vetëfinancuese dhe fitimprurëse përmes shitjes së materialit mbjellës, shërbimeve, granteve dhe projekteve ndërkombëtare. Detyrimet e saj financiare nuk transferohen te Buxheti i Shtetit.

Komente:

Znj. Kukalaj, Nënkyetare e bashkisë Krujë shtroi pyetjen nëse shoqëria do të administrojë edhe sipërfaqet e zonave të mbrojtura apo vetëm sipërfaqet e bashkive.

Znj. Marika në përgjigjen e saj theksoi se shoqëria nuk administron asnjë pjesë të fondit pyjor. Nëse ka kërkesë ose marrëveshje për projekte mbjelljeje apo restaurimi, kjo bëhet sipas kuadrit ligjor përkatës: Ligji për Zonat e Mbrojtura për AKZM-në, Ligji për Decentralizimin dhe Ligji 57/2020 për bashkitë.

Znj. Farrici sugjeroi që në relacionin shpjegues të citohet shprehimisht marrja në konsideratë e rekomandimeve të Shoqatës Kombëtare të Bashkive. Znj. Marika theksoi se projektligji dhe relacioni i përditësuar do t’ju rishpërndahen pasi kemi reflektuar të gjitha komentet e marra nga DAP, Ministria e Financave dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

2. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis" i ndryshuar *dhe*,
3. Projektvendimi "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 162 datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programit të pakësimit të shkarkimeve në ajër", propozuar nga Ministria e Mjedisit u prezantua nga Znj. Adriana Petri, Drejtor Drejtorie për Cilësinë e Ajrit dhe Statistikave në Mjedis.

Znj. Petri theksoi se ndryshimet në projektligjin për cilësinë e ajrit vijnë në kuadër të përafrimit me direktivën e re të BE-së të vitit 2024. Qëllimi është krijimi i një sistemi më efektiv monitorimi, vlerësimi dhe planifikimi. Projektligji përcakton qartë përgjegjësinë e bashkive për hartimin dhe zbatimin e planeve të cilësisë së ajrit kur kjo kërkohet nga kushtet ligjore (p.sh. në aglomerate apo zona me tejkallim të normave). Kur një zonë përfshin më shumë se një bashki, mund të hartohet një plan i përbashkët ndërvendor. Gjithashtu, bashkitë ngarkohen me hartimin e planeve afatshkurtra të veprimit në rast rreziku alarmues. Monitorimi kombëtar i ajrit mbetet përgjegjësi e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Bashkitë nuk e kanë detyrim automatik hartimin e planit, por vetëm në rastet kur konstatohen tejkallime të normave nga AKM-ja. Për sa i përket projektvendimit (VKM 162/2020), ai ka karakter teknik dhe metodologjik për përditësimin e inventarëve dhe projeksioneve të shkarkimeve (p.sh. karboni i zi, amoniaku). Ky vendim ngarkon kryesisht nivelin qendror dhe AKM-në, pa krijuar barra direkte financiare për bashkitë.

Komente:

Znj. Farrici theksoi se kërkohet më shumë bashkëpunim ndërinstitucional.

Z. Genci Kojdheli përfaqësues nga bashkia Tiranë shtroi dy sugjerime teknike si:

1. Për bashkitë që e kanë tashmë një plan të miratuar (si bashkia Tiranë), rregullimi i normave të reja teknike (*benchmarks*) të bëhet në mënyrë automatike/matematike në dispozitat tranzitore, pa pasur nevojë që plani të ribëhet ose të prokurohet nga e para me kosto shtesë kohore dhe financiare *dhe*,
2. Ndotësit kryesorë në Tiranë janë trafiku dhe ndërtimi. Ndërsa për ndërtimin bashkia ka taksa zbutëse, për sektorin e hidrokarbureve/transportit nuk ka. Sugjerojmë që bashkive t'u jepet akses në mekanizma financiarë (p.sh. një pjesë nga taksa e akcizës ose karburantit) që shkojnë direkt për përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Komente: Nuk ka

4. Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" të ndryshuar, propozuar nga Ministria e Brendshme, u prezantua nga z. Arben Xhaferri, Drejtor, Drejtorja e Prefekturave, Ministria e Brendshme.

Z. Xhaferri theksoi se projektligji synon forcimin e rolit të Prefektit të Qarkut si përfaqësues i Këshillit të Ministrave për bashkërendimin e punës me degët territoriale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, pa cenuar autonominë vendore, si dhe në vazhdimësi permendi ndryshimet

e ligjit si; Përfshirja e Policisë Bashkiake (përveç Policisë së Shtetit) në bashkërendimin e masave të rendit dhe sigurisë publike me Kryetarin e Bashkisë. Neni 3 (Neni 12/1) sipas të cilit prefekti merr pjesë në Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike dhe në Këshillin Kombëtar për Sigurinë në Komunitet, duke koordinuar problematikat e evidentuara në nivel qarku. Neni 4 (Neni 13) ku bashkërendohet puna me bashkitë, AKMC-në dhe Forcat e Armatosura për menaxhimin e emergjencave civile. Neni 5 (Neni 14/1) citon bashkërendimin ndërinstitucional për çështje me interes të përbashkët vendor dhe raportimi të Ministri përgjegjës/Kryeministri në rast se problematikat nuk gjejnë zgjidhje në nivel lokal.

Komente:

Znj. Farrici shprehu dakordësinë me projektligjin.

5. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2019 "Për nxitjen e punësimit" i ndryshuar, propozuar nga *Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit* u prezantua nga *Z. Albin Gega, Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Punësimit Profesional.*

Z. Gega në fjalën e tij theksoi se ndryshimet në ligjin e nxitjes së punësimit bëhen për përafrim me standardet e BE-së (Kapitujt 2 dhe 19), integrimin në rrjetin EURES, zbatimin e Garancisë Rinore, dixhitalizimin e shërbimeve (Pasaporta Dixhitale) dhe krijimin e Observatorit të Tregut të Punës.

Gjithashtu, *z. Gega* shtroi pikat kyçe për pushtetin vendor të përcaktuara në akt si:

- ✓ *Programet e Nxitjes së Punësimit ku bashkitë do të mund të dizajnojnë dhe zbatojnë drejtpërdrejt programe të targetuara për komunitetin dhe grupet vulnerabël (p.sh. komuniteti rom, emigrantët e kthyer).*
- ✓ *Garancia Rinore ku krijohet kuadri ligjor për partneritetet vendore. Bashkitë do të jenë aktorë kyç në rekrutimin dhe aktivizimin e të rinjve të moshës 15–29 vjeç që nuk janë në punë, arsim apo formim (NEETs), si dhe*
- ✓ *Kuponat dhe Kuotat e Punësimit ku rregullohet detyrimi për punësimin e personave nga grupet e veçanta (1 person për çdo 125 punonjës) ose kontributi prej 5% të pages minimale në Fondin Social të Punësimit*

Komente: Nuk ka

6. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social", të ndryshuar, propozuar nga *Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit*, u prezantua nga *Znj. Dardana Grabova, Drejtor i Drejtorisë së Strehimit*

Në fjalën e saj *znj. Grabova* theksoi se projektligji ndërhyr në 13 nene për të rritur efektivitetin e politikave të strehimit social, i cili mundëson që brenda të njëjtit objekt të ndërtohen banesa sociale me qira, banesa me kosto të ulët dhe banesa për shitje në treg të lirë, duke shmangur diferencat sociale. Shteti do të garantojë diferencën prej 20–30% ndërmjet çmimit të tregut dhe çmimit të referencës ose mbulimit bankar, në mënyrë që familjet përfituese të marrin 100% të vlerës së financimit. Fasha e formulës së zgjedhjes së përfituesve në bashki ndryshon nga 1/6 në 1/2, për

t'iu përshtatur rritjes së pagave dhe çmimeve të apartamenteve. Kontributi monetar i 3%-shit nga ndërtuesit do të përdoret për të gjitha programet e strehimit social në bashki, jo vetëm për ndërtim.

Komente:

Znj. Farrici shtroi komentet e saj si vijon:

Në nenin 15/2, të përcaktohet se kriteret e hollësishme për kategoritë e veçanta nxirren me VKM në përputhje me parimet e ligjit, për të shmangur delegimin e pakufizuar;

Të përcaktohet përqindja fikse e mbulimit në ligj dhe jo vetëm me VKM për garancinë Sovrane;

Në venet 18 dhe 22 duhet që tjetërsimi ose ndryshimi i destinacionit të pasurive sociale të mos ulë fondin publik të banesave, përveçse kur pasuritë zëvendësohen me një pasuri të barazvlefshme ose më të favorshme;

Në nenin 48, për familjet me të ardhura të ndryshueshme, të merret parasysh niveli i qëndrueshëm dhe i verifikueshëm si dhe të drejtat e fituara me ligjin e vjetër të mos cenuhen.

7. Projektvendimi “Për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillimin e sektorit minerar 2026-2040” dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Sektorit Minerar 2026–2040, propozuar nga *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë*, u prezantua nga *Z. Dori Dapi, Drejtor i Drejtorisë së Programeve dhe Zhvillimit të Industrisë Minerare, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë*.

Z. Dapi theksoi se dokumenti përcakton vizionin strategjik për zhvillimin e sektorit minerar deri në vitin 2040, me fokus të lëndët e para kritike dhe teknologjitë e gjelbra (bakër, nikeli, boksiti, kobalt). Lidhur me pushtetin vendor sqaroi se strategjia nuk delegon kompetenca të reja apo barra financiare për bashkitë. Bashkitë përfshihen në kuadër të kompetencave të tyre ekzistuese funksionale si: a) Integrimi i dimensionit minerar në Planet e Përgjithshme Vendorë (PPV); b) Dhënia e miratimeve teknike/territoriale dhe konsultimi me komunitetet lokale; c) Administrimi i ndikimeve mjedisore dhe mbrojtja e fondit pyjor vendor.

Komente:

Znj. Farrici sugjeroi që në planin kombëtar të rehabilitimit të zonave të dëmtuara nga aktiviteti minerar t'u jepet një rol më i rritur bashkive, pasi janë komunitetet lokale ato që përballen me pasojat mjedisore. *Z. Dapi* sqaroi se lidhur me rehabilitimin, ligji minerar përcakton se subjektet private paguajnë garanci financiare çdo 2 vjet për rehabilitimin mjedisor. Megjithatë, ne do ta rishikojmë këtë sugjerim për ta pasqyruar në kuadrin strategjik.

8. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, propozuar nga *Agjencia e Prokurimeve Publike*, u prezantua nga *Znj. Reida Kashta, Drejtor i Përgjithshëm APP-së*

Në fjalën e saj theksoi se projektligji vjen si kërkesë e përafrimit 100% të legjislacionit shqiptar me direktivat e BE-së në kuadër të Kapitullit 5. Ndryshimet nuk sjellin risi thelbësore apo rregulla të reja në zbatimin e përditshëm administrativ. Nenet e reja përfshijnë saktësime teknike dhe dispozita që do të bëhen të aplikueshme vetëm në momentin kur Shqipëria të anëtarësohet plotësisht në Bashkimin Evropian. Projektligji nuk vendos asnjë kusht ose barrë të veçantë shtesë për autoritetet kontraktore të pushtetit vendor.

Mbyllja e mbledhjes.

Në përfundim të takimit, Kryesuesi i mbledhjes, *Z. Stiljan Llavdaniti*, falënderoi të gjithë përfaqësuesit e Ministrive të linjës, Shoqatës së Bashkive dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre konstruktiv.

1. Shtojca 1: Të pranishëm në mbledhjen e zhvilluar më datë 2 shtator 2026

Anëtarët e Këshillit Konsultativ			
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni	Institucioni/Organizata
1	Hantin Bonati	Zv/ministër	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
2	Elda Xhumari	Zv/ministër	Ministria e Mjedisit
3	Elona Hoxha	Zv/ministër	Ministria e Drejtësisë
4	Fran Brahimi	Drejtor	Ministria e Financave
5	Arian Jaupllari	Zv/ministër	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
6	Agron Ivanaj	Kryetar	Shoqata e Këshillave të Qarqeve Lezhë

Bashkëlidhur mund të aksesoni linkun për aktin e diskutuar në mbledhjen e Këshillit Konsultativ datë 2 shtator 2026

Bashkëlidhur gjeni linkun e projektakteve që u diskutuan

<https://qeverisjavevendore.gov.al/keshlli-konsultativ/mbledhjet-e-keshillit-konsultativ/viti-2026/prill-2026/shtator-2026/>

Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ *E-mail: keshilli.konsultativ@amvv.gov.al Adresa:*
Bulevardi “Zhan d’Ark, ish- Shtëpia e Oficerave, Kati i VII”, Tiranë, Shqipëri.